



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	05.07/2021
Referenc-ë:	07-353/04-123837/21
Për/ Za/ To:	N.SH “Koperativa Communications”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-123837/21 nga N.SH “Koperativa Communications” për shfrytëzimin e hapësirës në rrugën “B” nga ora 07:00 deri në 09:00 dhe tek shkolla “Akademia e Shkencave, Ministria e Arsimit” përkatësisht në trotuarin e ngjitur përgjatë këtyre dy objekteve nga ora 14:00 deri në 17:00 me datë 06.07.2021 ku edhe do të xhirohet reklama.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike N.SH “Koperativa Communications” me datë 06 Korrik 2021 për xhirimin e reklamës në rrugën “B” nga ora 07:00 deri në 09:00 dhe tek shkolla “Akademia e Shkencave, Ministria e Arsimit” përkatësisht në trotuarin e ngjitur përgjatë këtyre dy objekteve nga ora 14:00 deri në 17:00.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.
- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve;

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.